

# POLICY BRIEF

## **Sfida dhe mundësi për riintegrimin e fëmijëve të kthyer nga emigracioni**

*Rasti i Bashkisë Gjirokastër*

Evis Fico

---

Eksperte në Drejtorinë e Shërbimeve  
të Punësimit dhe Migracionit

Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), në kuadër të programit “Përdorimi efikas i hulumtimit dhe advokimit mundëson politika më të mira evropiane në nivel lokal në Shqipëri”, drejtuar pjesëmarrësve të Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike. Programi ka për qëllim të mbështesë aktivitetet kërkimore dhe advokuese të alumnëve të Shkollës (rreth 300 drejtues të rinj nga profile dhe eksperiencia të ndryshme profesionale) me synim përmirësimin e politikave në nivel vendor.

Punimet hulumtuese u fokusuan në këtë fushë për shkak të implikimeve të rëndësishme të reformës administrativo-territoriale në nivelin e demokracisë vendore si dhe zhvillimeve të vullshme në qeverisjen vendore, të cilat kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me shërbimet që afrohen dhe janë të prekshme nga çdo qytetar.

Alumnët e përfshirë në këtë program patën mundësi të ndiqnin në terren pranë njësive të reja vendore ecurinë dhe problematikën e hasur në zbatimin e reformës administrativo-territoriale. Duke përballur eksperiencën e tyre profesionale dhe vendosur atë në kontekstin e zhvillimeve të përditshme të njësive të reja vendore, punimet e alumnëve tentojnë që të evidentojnë shembujt pozitivë në njësi të caktuara me qëllim replikimin në njësi të tjera, si dhe të ofrojnë rekomandime konkrete për përmirësimin e praktikave aktuale.

Këto punime kërkimore synohet të prezantohen në aktivitete publike apo advokuese me pjesëmarrjen e vendimmarrësve dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm, të cilët vijnë nga rrjeti alumni i shkollës dhe jo vetëm. Ofrimi i ekspertizës profesionale të këtyre hulumtimeve ndaj politikëbërësve siguron gjithashtu një platformë diskutimesh për shkëmbimin e ndërsjelltë të ideve të reja. Nga njëra anë, alumnët pjesëmarrës të këtyre aktiviteteve kanë mundësinë të sjellin rekomandimet e tyre për hartuesit e politikave të rëndësishme, por njëkohësisht, edhe vetë ata bëhen më aktivë dhe shërbejnë si përçues nga lart-poshtë të këtyre ideve tek shtresat e tjera të shoqërisë. Publikimi i mëtejshëm i hulumtimeve dhe ngjallja e interesit të publikut të gjerë do të ndihmojnë në krijimin e politikave dhe vendimmarrjen e orientuar nga konsultimi me publikun si dhe angazhimin e mëtejshëm të qytetarëve në këto procese politikëbërëse.

Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron opinionin zyrtar të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe të Akademisë së Studimeve Politike. Përgjegjësia për informacionin dhe pikëpamjet e shprehura në publikim i përkasin tërësisht autorëve. Autorët falenderojnë mentoren znj. Gentiola Madhi për mbështetjen dhe sugjerimet e dhëna në hartimin e këtyre punimeve.

## PËRMBLEDHJE

Shqipëria ka krijuar një mekanizëm për ri-integrimin e emigrantëve të kthyer, por vetë dukuria komplekse e migracionit dhe krizat globale kanë treguar se ky mekanizëm nuk ka arritur të përmbushë qëllimin për të cilin u krijuar. Të shumtë janë faktorët PULL and PUSH (tërheqës dhe shtytës) për këtë situatë, por është e vështirë të rëndojë përgjegjësia vetëm tek ky mekanizëm apo tek mungesa e koordinimit mes institucioneve përgjegjëse qeveritare; moskoordinim që fare mirë mund të kompromentojë zbatimin e politikave kombëtare.

Nisur dhe nga vala e paprecedentë migratore e viteve të fundit, qasja e re e politikave evropiane ndaj migrimit dhe riintegrit, në mungesë të një strategjie afatgjatë migracioni, e kalon detyrën tek pushteti vendor si i vetmi autoritet më afër individit dhe nevojave të tij. Parë në këtë optikë, lind pyetja se si është për qasja e pushtetit vendor në vendin tonë ndaj riintegrit të migrantëve dhe sidomos fëmijëve të tyre. A ka kapacitete njerëzore dhe financiare për të menaxhuar një riintegrim të suksesshëm dhe të qëndrueshëm, aspak denigrues apo shtytës për të riemigruar?

Ky dokument i shkurtër politikash synon të analizojë dhe vlerësojë riintegrimin e fëmijëve të kthyer nga emigrimi, si një kategori e ndjeshme dhe me rrezik përjashtimi social. Punimi do të fokusohet në rastin e Bashkisë së Gjirokastrës, duke marrë nën analizë kapacitetet dhe nivelin e përgatitjes së strukturave të pushtetit lokal përgjegjëse për monitorimin dhe riintegrimin e emigrantëve.

## HYRJE

Si vetë vala e paprecedentë e fenomenit të migracionit në të gjithë Evropën, nga 'polikrizat' e deri tek e ashtuquajtura 'pranvera arabe', edhe konfigurimi i migracionit të kthimit në Shqipëri ka pësuar ndryshime. *Migracioni i kthimit*, ashtu si dhe për qasja politike e qeverisë shqiptare ndaj tij, u shfaqën fuqishëm në vitet 2006 – 2010. Kjo periudhë përkoji me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Ripranimit dhe me miratimin e [Strategjisë së riintegrit të shqiptarëve të kthyer](#), si dy hapa të rëndësishëm dhe komponentë bindës për procesin e liberalizimit të vizave. Migracioni i kthimit si dukuri referohet si migrantëve të rregullt edhe atyre të parregullt. Ndërsa në vitet e fundit këtij konfigurimi të kthimit i është shtuar edhe grupi i personave të cilët përdorën instrumentin e

**azilkërkimit**<sup>1</sup> si mjet për të emigruar në vendet e BE-së për motive punësimi.

**Kutia 1:** Fakte dhe të dhëna mbi migrimin e kthimit në Shqipëri.

Statistikat tregojnë se migracioni i kthimit për periudhën 2009-2013 kap shifrën e **133,544** shqiptarëve. Ndërkaq sipas shifrave të Eurostat, janë afro **65, 935** shqiptarë që kanë aplikuar për azil në vendet e BE-së për vitin 2015, duke përbërë kështu **5%** të totalit të aplikantëve në vendet e BE-së gjatë këtij viti. Në të gjithë këtë kompozim numrash emigrantësh të kthyer nuk mund të harrojmë një kategori të veçantë sociale, siç janë **fëmijët**. Ata zënë jo pak por **36%** të azilkërkuesve për periudhën 2014-2015.

Burimi: [Instat & IOM](#), 2013; [Eurostat](#), 2016.

Nëse do të flasim me gjuhën e shifrave, është e vështirë të përcjellësh një panoramë të qartë të kësaj dukurie komplekse lëvizjeje në vlera sasiorë. Burimet e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) për vitin 2015 deklarojnë se 1/3 e të kthyerve në Shqipëri janë fëmijë<sup>2</sup>. Kësisoj, kthimi jo vetëm i migrantëve të rregullt - të cilët zgjedhin vullnetarisht të kthehen në vend - por dhe kategorisë së cilës u është refuzuar kërkesa për azil, është **shoqëruar nga një masë e konsiderueshme e fëmijëve dhe të rinjve të paarsimuar apo kualifikuar**. Ata "vuajnë" apo "gëzojnë" pasojat e vendimeve të kthimeve apo lëvizjeve migratore të prindërve të tyre, ndaj shfaqin qartazi nevojën për një riintegrim të përshtatshëm, përfshirë këtu aspektin psiko-social, arsimor, kulturor dhe gjuhësor.

Nga sa më sipër, ky dokument i shkurtër politikash synon të analizojë dhe vlerësojë riintegrimin e fëmijëve të kthyer nga emigrimi, si një kategori e ndjeshme dhe me rrezik për-

1 Sipas Eurostat (2016), termi azilkërkues përkufizohet si "një individ i cili ka aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare ose është i përfshirë për herë të parë në këtë aplikim si anëtar i një familjeje". Ndërkohë IOM (2015) e përkufizon *azilkërkuesin* si "një person i cili kërkon mbrojtje dhe siguri prej persekutimit serioz në një vend tjetër i tij apo në vendin e tij, dhe pret një përgjigje të kërkesës për statusin e refugjatit sipas instrumentave ndërkombëtarë dhe kombëtarë".

2 Deklaratë B.Klosi ish-Ministër i MMSR-së gjatë fjalës së tij në prezantimin e projektit për riintegrimin e fëmijëve të emigrantëve të kthyer

jashtimi social. Punimi do të fokusohet në rastin e Bashkisë së Gjirokastrës, duke marrë nën analizë kapacitetet dhe nivelin e përgatitjes së strukturave të pushtetit lokal përgjegjëse për monitorimin dhe riintegrimin e emigrantëve.

Në veçanti, ky dokument politikash adreson këto pyetje specifike:

- A funksionon **sistemi integruar i fëmijëve**? A ekziston **një plan social** në nivel qarku në kuadër të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve?
- Si bashkërendohet puna midis Bashkisë, Drejtorisë Arsimore Rajonale-Zyrës Arsimore dhe Shërbimit Social apo organizatave që operojnë në këtë fushë për riintegrimin e familjeve të të kthyerve dhe veçanërisht të fëmijëve të tyre?

Përsa i përket metodologjisë së hartimit të këtij punimi, u mbledhën të dhëna nga institucionet publike si dhe intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues/zyrtarë përgjegjës që merren me trajtimin e fëmijëve dhe shërbimet ndaj tyre të këtyre institucioneve: Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, organizata 'Observatori për të Drejtat e Fëmijëve', organizata 'Terre Des Hommes', Ambasada Austriake, Bashkia e Gjirokastrës, Drejtoria Arsimore, Qendra Kombëtare e Fëmijëve, Drejtoria Rajonale dhe Shërbimi Social Shtetëror në Gjirokastrë.

## KUADRI POLITIK, LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948) thekson në nenin 13/2 se "çdokush ka të drejtën të kthehet në vendin e tij". Këtu përfshihet riintegrimi kulturor, ekonomik dhe shoqëror i të kthyerit në komunitetin/vendin ku vendoset. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, edhe pse nuk e ka të shprehur në formë afirmative të drejtën e kthimit, e trajton atë në nenin 39/1 si ndalim të dëbimit të shtetasit shqiptar nga territori. Gjithashtu, edhe në nenin 15/2 sanksionohet që "organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre".

Sipas një studimi të kryer në 2015, aktual-

isht ekzistojnë 73 dokumente të Qeverisë së Shqipërisë që trajtojnë të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve si dhe kthimin dhe riintegrimin të tyre. Mes tyre mund të përmendim këto dokumente:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015-2020;
- Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, 2014 – 2020;
- Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale, 2016 – 2020;
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2014 – 2020;
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, 2017-2020;
- Ligji i ri nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", në nenin 46 sanksionon:

*"Roli i Bashkisë është i veçantë dhe ka një sërë detyrash përpara në lidhje me kategorinë e fëmijëve, por këtu do të veçonim pikërisht më konkretisht mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera vendore, për situatën e të drejtave të fëmijës dhe familjeve, me qëllim hartimin e programeve që krijojnë një mjedis mbështetës për zhvillimin optimal të fëmijës."*

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.573, datë 24.6.2015, specifikon se:

*Standardet e Shërbimeve të Njërive të Mbrojtjes së Fëmijëve shërbejnë për të matur dhe përmirësuar cilësinë e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në bashki dhe krijojnë edhe bazën për inspektimin e tyre nga strukturat në nivel qendror. Standardet janë mbështetur në pesë fusha specifike, por të ndërlydhura midis tyre që përfshijnë kriteret për cilësinë. Duhet theksuar se fëmijët e kthyer trajtohen në kuadër të mbështetjes së fëmijëve në nevojë.*

- Udhëzimi i Përbashkët "Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës" i nënshkruar nga katër ministra (Ministri i

Arsimit, i Shëndetësisë, i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe Ministri i Brendshëm), me qëllim përcaktimin e detyrave, përgjegjësi dhe procedurave standarde për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

Ndërkohë ekzistojnë **21 institucione shtetërore në nivel kombëtar, 15 organizata joqeveritare dhe 9 institucione në nivel Qarku Gjirokastrë** që merren me të dhënat dhe trajtimin e fëmijëve. Në veçanti do të përmendim:

- Drejtoria e kufirit dhe migracionit;
- Sportelet e migracionit në nivel lokal brenda 36 zyrave të punës;
- Agjencia për mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror dhe lokal;
- Shërbimi Social Shtetëror;
- Drejtoria Arsimore/Zyrat Arsimore;
- Njësitë për fëmijët në nivel qarku dhe në nivel bashkie (njëra është për të drejtat e fëmijëve dhe tjetra për mbrojtjen e fëmijëve);
- Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve -organ i krijuar me ligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, i cili qëndron në krye të koordinimit programor dhe mbikëqyr përmbushjen e këtyre të drejtave.

## SITUATA AKTUALE

Një numër i konsiderueshëm i emigrantëve shqiptarë të sapo kthyer janë fëmijë, si pjestarë të familjeve që kohët e fundit rezultojnë të vijnë nga vendet si Gjermania, Franca, Suedia dhe Holanda. Kthimi i tyre sipas [studimit](#) tëbërë nga Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM) për “identifikimin e zonave më të prekura nga migracioni i kthimit”, kap kryesisht prefekturat Durrës, Tiranë, Vlorë, Kukës, Peshkopi, dhe Gjirokastrë. Edhe pse studimi është kryer vite më parë, sipas [INSTAT](#), dukuria e kthimit më të lartë vihet re pikërisht në këto prefektura për shkak të vendodhjes gjeografike dhe zhvillimit ekonomik në to.

*Shqipëria nuk ka kryer ende ndonjë vlerësim të mirëfilltë të nevojave të komuniteteve ku migrantët vendosen pas kthimit. Gjithashtu nuk ka bërë përpjekje për të hartuar politika riintegruese që marin në konsideratë nevojat e migrantëve por edhe të komuniteteve.*

**Përballja e parë e të kthyerve janë institucionet e pushtetit lokal.** Në këndvështrimin ligjor dhe strategjik ekziston një [Mekanizëm Kombëtar Referimi](#) (MKR), të cilin qeveria shqiptare e ngriti në vitin 2010. Ai është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë njësitë administrative, për realizimin e njëriintegritetit qëndrueshëm dhe të suksesshëm të të kthyerve.

Hallka kyçe e këtij procesi janë sportelet e migracionit. Të ngritura si pjesë integrale e 36 zyrave të punësimit për të pritur dhe dhënë informacionin më të domosdoshëm tek të kthyerit, ato shërbejnë si urë lidhëse me institucionet e tjera të shërbimeve publike dhe private. Ky proces, nga pritja deri në njëriintegrim real apo referim tek institucionet përkatëse në varësi të problematikës, në praktikë has jo pak vështirësi, për shkaqe subjektive dhe objektive. Raporti i MMSR-së për vitin 2016 ilustron se paraqitja e shtetasve bëhet vullnetarisht dhe për pasojë ka vetëm 289 shtetas shqiptarë të kthyer nga emigracioni, një shifër që nuk i përgjigjet fluksit të lartë real. Në karakteristikat sipas moshës nuk reflektohen fëmijët deri në 18 vjeç, duke mos raportuar asnjë të dhënë për fëmijët. *Shkaqet kryesore të kësaj situale lidhen me mungesën e plotësisht të kushteve primare, me vullnetin e vakët për bashkëpunim, si dhe me moskoordinimin midis institucioneve shtetërore. Duhet theksuar që ky është një proces zinxhir që kërkon kohë dhe përkushtim profesional.*

## RASTI I GJIROKASTRËS

Në Shqipëri që prej vitit 2005 përgjegjësia për mbrojtjen e kategorive vulnerabel apo në rrezik, si dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror i është deleguar nivelit të qeverisjes vendore. Por, në praktikë vetëm prej 2015 me reformën e shërbimeve shoqërore të zhvilluar paralelisht me reformën territoriale, u bënë ndryshime të rëndësishme ligjore, veçanërisht me miratimin e Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror” si dhe lig-



jit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Ato kanë krijuar kuadrin e përshtatshëm ligjor për të bërë të mundur **ngritjen dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes dhe përkujdesit shoqëror për grupet vulnerabël në tërësi dhe fëmijët në veçanti në nivelin vendor.**

Referuar edhe ligjit më të ri ndërsektorial nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, vihet re një fuqizim i rolit të bashkisë si institucion kryesor në trajtimin dhe zhvillimin e proceseve.<sup>3</sup> Në frymën e këtij ligji do të krijohet një rrjet i sigurtë rreth fëmijës kudo ku ai ndodhet, në shtëpi, në shkollë, në komunitet. Ky ligj, përveç të drejtave të fëmijëve, trajton për herë të parë aspektin e mbrojtjes së fëmijëve si një trajtim jo rast pas rasti por, si një detyrë institucionale, duke parashikuar masat mbrojtëse që jepen nga strukturat e pushtetit vendor.

Por pse u mor në analizë rasti i Bashkisë së Gjirokastrës? Së pari, Gjirokastra është një prej prefekturave më të prekura nga fenomeni i migracionit të kthimit, kjo dhe për shkak të pozitës gjeografike pranë shtetit grek. Së dyti, gjatë hulumtimit nuk rezultoi asnjë studim mbi zonat që trajtojnë fëmijë të kthyer, veçanërisht në këtë zonë. Së treti, nga intervistat kryera me aktorët shtetërorë dhe të shoqërisë civile u përcoll shqetësimi i një numri të lartë të kthyerish në këtë bashki. Si një njësi vendore me vlera të patjetërsueshme në trashëgiminë kulturore, shërbimi ndaj fëmijëve i jep shtysë për të treguar po kaq vlera edhe në aspektin social.

## PROBLEMATIKA

Në nivel gjithpërfshirës dhe jo vetëm në Bashkinë e Gjirokastrës mbetet ende punë për të bërë lidhur me funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit. I ashtuquajtur ndryshe ‘mekanizëm riintegrimi’, ai shpjegon procedurën e informimit dhe referimit të të kthyerit

3 Sipas nenit 46 të ligjit nr. 18/2017 : “Bashkitë janë përgjegjëse për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative në varësi të tyre të strukturave përkatëse për mbrojtjen e fëmijës, në zbatim të standardeve dhe, nëpërmjet tyre, të një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës, duke siguruar, ndërmjet të tjerash: a) pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijës në planet e zhvillimit vendor, në programet dhe projektet, në përputhje me politikat kombëtare; b) parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës; c) zhvillimin e programeve dhe projekteve për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që vënë në rrezik jetën dhe integritetin moral, fizik, psikologjik e emocional të fëmijës”.

drejt shërbimeve, që nga momenti i hyrjes në pikën e kalimit kufitar në Shqipëri dhe deri në momentin e aksesimit të shërbimeve publike.

Nga hulumtimet e kryera vërehet se nuk ekziston ende një raport i impaktit të këtij mekanizmi, **apo i ndjekjeve të rasteve të riintegrit nga fillimi deri në fund.** Duhet thënë gjithashtu se [rastet e asistimit tek ky grup shoqëror](#) (si të mitur të pashoqëruar, fëmijë të komunitetit rom apo emigrantë të kthyer) mungojnë.

Vihet re një keqfunksionim i Grupeve të Punës Multidisiplinore për sigurimin e një qasje/koordinimi ndërsektorial në trajtimin e rasteve. Sipas [studimit të hartëzimit dhe analizimit për mbrojtjen e fëmijës në Shqipëri](#) dëshmohej qartazi se në mbarë qarqet dhe bashkitë e vizituara Grupet e Punës Multidisiplinore *lënë shumë për të dëshiruar në funksionimin e tyre.*

Në shembullin e Gjirokastrës këto referime lidhur me fëmijët janë sporadike. Edhe pse Bashkia ka njw numwr prej 52, 797 në asnjë prej njësive administrative nuk ka punonjës për fëmijët. Funksionet mbulohen nga njësia e mbrojtjes së fëmijës në Bashki, e cila nuk ka të dhëna lidhur me fëmijët e kthyer nga emigracioni. Sipas intervistës me punonjës të bashkisë<sup>4</sup>, [puna me trajtimin e fëmijës është zinxhir dhe nuk duhet të presë të jetë në rregull vetëm me pjesën burokratike të shkresave duke vonuar kështu trajtimin e rastit.](#) Në fakt nuk ka strukturë të posaçme siç e kërkon ligji, sikurse ka vetëm 1 punonjës të mbrojtjes së fëmijës.

Ligjërisht Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie. Ajo ka për detyrë në mënyrë të posaçme parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik ose/ dhe në nevojë për mbrojtje. *Por, në praktikë kjo njësi nuk ka facilitetet për realizimin e detyrimit të mësipërm si në aspektin e burimeve njerëzore dhe detyrave funksionale, po ashtu fëmijët e em-*

4 Sipas nenit 50 pika 2. Çdo njësi administrative e bashkisë, e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, ka, minimalisht, një punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Ata nuk mund të angazhohen në detyra të tjera brenda njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit. Në rastet kur njësia administrative e bashkisë ka më pak se 3000 fëmijë, këtë detyrë mund ta kryejë njëri nga punonjësit e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, i cili ka të përcaktuar në përshkrimin e punës funksionin si punonjës për mbrojtjen e fëmijës.

igrantëve të kthyer trajtohen në kuadër të fëmijëve në nevojë. Njësia mbulohet nga një person i vetëm në organikë i njohur me emërtesën: Specialist për Diskriminimin, Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Komuniteteve në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe Kulturor<sup>5</sup>. Plani individual i padokumentuar, mungesa e buxhetit të nevojshëm dhe e stafit, zvogëlon mundësinë e ndjekjes dhe riintegritimit. (Në Bashkinë Gjirokastrë, fondet e dedikuara për Drejtorinë e Shërbimeve Social-Kulturore shkojnë për aktivitete kulturore. Njësia e mbrojtjes së fëmijëve nuk ka buxhet). Në kreun III “Mekanizmat institucional për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 34 përcakton si *mekanizëm këshillimor dhe koordinues institucional në nivelin vendor grupin teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative*. Ndërkohë *strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë:*

- a) Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në Bashki;
- b) Njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
- c) Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësie administrative;
- d) Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

*Për vitin akademik 2015-2016 ka një numër të regjistruarish prej 10 nxënësish në ciklin fillor dhe 11 në cikline lartë.*

*Për vitin akademik 2016-2017 ka një numër prej 3 nxënësish në ciklin fillor dhe 7 të tillë në ciklin e lartë.*

Detyrat e përcaktuara nga ligji për secilën prej këtyre strukturave në këndvështrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta që ofrojnë për fëmijët apo referimit në shërbime specifike sipas nevojave të fëmijës janë pjesë e rëndësishme e Planit të Mbrojtjes së Fëmijës në këtë Bashki.

Shërbimet e Bashkisë së Gjirokastrës kundrejt fëmijëve janë:

1. Regjistrim në zyrën e Gjendjes Civile në bashkëpunim me organizatën jo qeveritare TLAS (asistencë juridike falas);
2. Regjistrim në kopësht (parashkollor) pa pagesë;
3. Regjistrim në klasat e shansit të dytë;
4. Regjistrim në Qendrën Kulturore të Fëmijëve;
5. Fushatë sensibilizuese në komunitet.

Në Bashki ka njësi të mirëfillta për fëmijët por që ende nuk kanë raporte përsa i përket fëmijëve të kthyer. Numri i fëmijëve gjithsej të moshës 6-18 vjeç që frekuentojnë shkollën është **5428** gjithsej, ku: 3950 nxënës frekuentojnë shkollat në qytet dhe 940 nxënës në fshatra. Njësia që rezultojnë me të dhëna koherente të fëmijëve nga emigracioni është Drejtoria Arsimore Gjirokastrë, e cila për vitin akademik 2015-2016 ka një numër të regjistruarish prej 10 nxënësish në ciklin fillor dhe 11 nxënës në atë të lartë; ndërsa për vitin akademik 2016-2017 ka një numër prej 3 nxënësish të regjistruarish në ciklin fillor dhe 7 të tillë në ciklin e lartë. Ndërkohë në **Qendrën Kulturore të Fëmijëve nuk rezultojnë asnjë raport mbi situatën e fëmijëve të kthyer nga emigracioni që marrin pjesë në kurse.**

**Nga intervistat e kryera vërehet se nuk ka të dhëna jo vetëm për trajtimin dhe kujdesin psikosocial të fëmijëve, por as të emigrantëve të kthyer.** Madje, nuk ekziston asnjë sistem i mirëfilltë i dokumentuar për ndjekjen e rasteve. Për shembull, nuk jepet informacion nga administratori i ndihmës ekonomike për familjet në nevojë.

Në intervistat me përfaqësues të organizatave “Observatori i të Drejtave të Fëmijës” dhe “Terre des Hommes” u theksua fakti se Gjirokastra do të jetë ndërhyrja e radhës me projektet e tyre për fëmijët. Sipas deklaratimit të tyre ende nuk ekziston një vëzhgim apo studim për të vlerësuar se cilat zona janë më të përkrahura apo kanë më shumë fëmijë të kthyer me familjet e tyre nga emigracioni. Në supozimin se ata trajtohen përmes programeve specifike shumë

<sup>5</sup> Është pak i argumentueshëm ky formatim organikë për shërbimet sociale dhe kulturore

shpesh ky grupim e gjen veten jashtë skemave të ndihmës.

## ANALIZA E ZGJIDHJEVE

Duke qënë se koordinimi nuk është funksional dhe shpesh herë vuan për shkaqe subjektive, facilitetesh apo për mungesë vullneti dhe fryme kolektive në ndërmarrje vendimesh të përbashkëta, shihet i nevojshëm një planifikim dhe menaxhim efektiv i shërbimeve ndaj fëmijëve. Ai kërkon profesionalizëm dhe punë të bashkërenduar, po aq edhe një advokim të përjasjes së politikave për zbatimin më të mirë të tyre.

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2014-2020 parashikon nevojën që udhëheqja vendore të zhvillojë shërbime cilësore të kujdesit shoqëror përmes një angazhimi më të madh të vlerësimit të nevojave dhe proceseve të planifikimit të shërbimeve. Për trajtimin e fëmijëve nevojiten shërbimet të shumëllojshme më të përgjegjshme dhe të integruara. **Kjo nuk do të thotë pasja e shumë institucioneve, por shtim të shërbimeve.**

Kështu, pavarësisht numrit të lartë të fëmijëve të kthyer dhe problematikës të hasur me ta, aktualisht po punohet vetëm me 80 familje në kuadër të një projekti pilot të financuar nga Agjensia Austriake për Zhvillim (ADA), në rajonet e Fierit, Shkodrës, Korçës dhe Lezhës<sup>6</sup>. Po më tej a do të vazhdojë kjo mbështetje? Përballë institucioneve shtetërore lind detyra e shtrirjes së shërbimeve dhe sigurimit të vijueshmërisë së tyre kudo ku haset fenomeni i migracionit të kthimit të fëmijëve.

## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ky punim nxorri në pah një sërë problematikash në zbatimin e politikave dhe legjislacionit për riintegrimin e shtetasve të kthyer nga emigracioni me fokus fëmijët. Moskoordinimi ndërinstitutional, mbivendosja e detyrave, paqartësia e kompetencave dhe padyshim mungesa e një raporti aktual të fakteve dhe të dhënave për kategorinë e fëmijëve të kthyer nga emigracioni i vendosin institucionet qendrore dhe pushtetin vendor përballë një sfide dhe detyre të rëndësishme: atë të shërbimit

të drejtëpërdrejtë me qytetarin, konkretisht fëmijët dhe dhënien e ndihmës të nevojshme ndaj tij. Mbi bazën e gjetjeve, ky punim vjen me disa rekomadime për institucionet që merren me mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve.

### 1. Për institucionet qendrore

- Ndarja e qartë e përgjegjësiwe përkatëse dhe bashkëpunimi ndërinstitutional është kyç për funksionimin e sistemit të referimit dhe shkëmbimin reciprok të informacionit ndërmjet Sporteve të Migracionit dhe institucioneve qendrore e në varësi;
- Mbetet domosdoshmëri hartimi i një strategjie afatgjatë për riintegrimin dhe politikave riintegruese që marrin në konsideratë nevojat e migrantëve por edhe të komuniteteve. Gjithashtu, nevojitet një monitorim konstant i impaktit të Mekanizmit të Referimit;
- Rekomandohet inserimi në buxhetin e shtetit i një zëri të veçantë për kategorinë e emigrantëve të kthyer dhe fëmijëve të tyre;

### 2. Për Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit

- Rekomandohet hartimi i një studimi të mirëfilltë për kategorinë e fëmijëve të kthyer me qëllim përshtatjen e kurrikulave në ndihmë të tyre dhe rritjen e kapaciteteve të stafit mësimor.

### 3. Për Shërbimin Social Shtetëror

- Edhe pse hartëzimi i shërbimeve sociale ka ngritur strukturat e nevojshme me ligjin e ri të shërbimeve sociale hyrëne fuqi në nëntor 2016, sërish nga studimi rezultoi një gjendje e vakët për sa i përket trajtimit të familjeve të kthyer apo fëmijëve të tyre. Në këto kushte del si prioritet që duhet punuar shumë me rritjen e ndërgjegjësimin për këtë shërbim në lokalitet dhe njëkohësisht bashkëpunim më të fuqishëm në lidhje me planin social.
- Rritja e efikasitetit përtej aspektit ligjor ka të bëjë dhe me angazhimin profesional të stafit. Kjo me qëllim njohjen e shërbimeve të tyre në komunitet për të

<sup>6</sup> Projekt i financuar nga ADA me titull "Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe riintegrimin të fëmijëve të migrantëve në Shqipëri", Nisja më 01.04.2016 dhe përfundimi më 31.03.2019.



mos u kthyer në shërbime të rëndomta burokratike por në shërbime koordinuese sociale me qëllim përfshirjen e kategorive në nevojë.

#### 4. Për bashkitë

- Rekomandohet një rritje e burimeve njerëzore dhe financiare në nivel njësie për Mbrojtjen e Fëmijë në nivel bashkie. Gjithashtu, punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve kanë nevojë përforcim të kapaciteteve dhe lehtësim të procedurave për mirëkoordinim dhe gadishmëri operative në trajtimin e rasteve.
- Të krijohet një mjedis i sigurt për fëmijët përmes ngritjes së një sistemi të integruar të mbrojtjes dhe përkujdesjes për ta.
- Bashkia të ngrejë Njësine e Mbrojtjes së Fëmijëve me të paktën 2 punonjës të mbrojtjes së fëmijës sipas VKM Nr. 353 datë 12.06.2018 “Për regullat e Funkcjonimit të Grupit Teknik Ndërsektorial për Mbrojtjen e Fëmijëve, pranë Bashkive dhe Njësive Administrative.

#### 5. Për Drejtoritë Arsimore

- Edhe pse një nga elementët e rëndësishëm të shërbimeve të informacionit ka qenë edhe ofrimi i informacionit për arsimimin e fëmijët të emigrantëve të kthyer (regjistrimi në sistemin arsimor, procedura e njohjes së diplomave të fituara jashtë shtetit, dhe referimi i tyre në Drejtoritë Rajonale të Arsim-it), ka nevojë për më shumë shërbime mbështetëse për riintegrimin e shtetasve të kthyer në sistemin arsimor shqiptar.
- Rekomandohet hartimi i një raporti vlerësues mbi situatën e fëmijëve emigrantë të kthyer dhe shërbimet e ofruara pas përfundimit të orarit të mësimit për të ndihmuar përfshirjen dhe integrimin e tyre gjuhësor e social.

#### 6. Për organizatat joqeveritare

- Organizat që operojnë në këtë fushë të jenë operative jo vetëm në pjesën e trajnimit të personelit por edhe të ngritjes së kapaciteteve infrastrukturore në menaxhimin e rasteve<sup>7</sup>.

<sup>7</sup> Referuar intervistës së bërë në 22 Gusht 2017 me punonjësen F.B rastet i ndiqte me mjetet personale pasi nuk ka patur mundësi të tjera.

## BURIME

Dibra Sidita, Semini Irma & Marsela Allmuca, Reintegration of young asylum seekers in the Albanian Education System, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Maj 2016.

Grazhdani Teuta, “Shërbimet e riintegrim-it për emigrantët shqiptarë që kthehen: mes sfidave të parandalimit të emigracionit dhe forcimit të institucioneve”, Universiteti i Tiranës, 2015.

INSTAT & IOM, «Return Migration and Reintegration in Albania», Tiranë, 2014.

IOM, “Identifikimi i zonave më të prekura nga emigracioni dhe migracioni i kthimit në Shqipëri: Profili i migrantëve të kthyer”, Dh-

jetor 2008.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, “Çfarë ndodh me familjet dhe fëmijët shqiptarë të kthyer? Gjetjet kryesore nga vlerësimi i aksesit në shërbime për migrantët e kthyer në Tiranë, Dibër dhe Fier”, Maj 2017.

Raporti i MMSR mbi shërbimet ri-integruese në mbështetje të emigrantëve shqiptarë që kthehen në vend nga Spotelet e Migracionit (2016 - 3 muhor 2017).

Terre Des Hommes, “Hartëzimi dhe analiza e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri. Dokument gjithëpërfshirës i praktikave dhe perceptimeve», Tetor 2015.